


SHQIPËRIA AKTUALITET

Arrestohet “i forti” i Tiranës, si iu shpëtoi 3 atentateve

13:58 | 09/10/2019

**Madhësia e tekstit : A A A**

Ka përfunduar në prangat e Policisë së Tiranës, Elvis Gaçaj, i konsideruar si një person me rrezikshmëri të lartë. Gaçaj i kishte ikur postbllokut të policisë, dhe për këtë arsye ishte vënë në ndjekje të tyre. Pas kontrollit, iu gjet një armë pa leje.

I arrestuari është po ashtu pjesë e grupit ‘Duka’, ndërsa u arrestua në prill të këtij vit bashkë me Leonard Dukën, Dritan Agajn dhe Oltion Loga. Asokohe, Policia u gjeti në banesë armë dhe municione luftarake.

Elvis Gaçaj, në 2015 ka qenë objekt i një atentati tek “Lulishte 1 Maji” në Tiranë, ku mbetën të vrarë gabimisht dy persona, ndërsa ai u plagos. Ai akuzohet edhe për parcelat e hashashit në zonën e Shëngjergjit, si personi që i dispononte dhe financonte me lëndë narkotike.

44-vjeçari, i cili cilësohet edhe si i “forti” i Tiranës, gjatë viteve 2013-2015 u kishte shpëtuar edhe dy atentateve të tjera, ndërkohë që sulmet e mëparshme për ta eliminuar ishin kryer me eksploziv.

Në atentatin e parë u plagos lehtë nga shpërthimi i një sasive tritoli në makinë. Atentati i dytë mbeti në tentativë, pasi lënda plasëse nuk shpërtheu. Gaçaj akuzohet se ka kryer një vrasje në vitin 1992 dhe një plagosje në vitin 2008.

ETIKETA

Elvis Gaçaj

i forti i Tiranës

Policisë së Tiranës

Më shumë nga kategoria